



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës/ Ministarstvo Obrazovanja, i Naukei / Ministry of
Education and Science*

Prishtinë, 16.04.2024

Në bazë të Rregullores MF- Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, **Divizioni i arsimit gjithëpërfshirës** *nxjerr këtë:*

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që përkrahin nxënësit me IQ të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti

1. **Divizioni i arsimit gjithëpërfshirës**, u bën thirrje të gjitha organizatave joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës së të cilave është i fokusuar në ndonjërin nga fushat e ndërlidhura me përkrahjen e nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në promovimin e këtyre nxënësve

2. OJQ-të, në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre për fushat prioritare në vijim:

1. *Hartimi i programeve për identifikimin dhe përkrahjen e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, me dhunti dhe talente.*

2. *Ngritja e kapaciteteve për identifikimin dhe përkrahjen e fëmijëve me aftësi të jashtëzakonshëm, me dhunti dhe talente.*

3. *Përkrahja e garave për nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente.*

3. Organizatat joqeveritare mund të aplikojnë në një ose dy projekte që kontribuojnë në përkrahjen e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente.

- ✓ Trajnimin e mësimdhënësve për identifikimin dhe përkrahjen e fëmijëve me aftësi të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti.
- ✓ Trajnimin e trajnerëve për ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës për identifikimin dhe përkrahjen e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti.
- ✓ Trajnimin e psikologëve për identifikimin dhe vlerësimin e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti.
- ✓ Aktivitete që synojnë organizimin dhe mbështetjen e garave në fusha të ndryshme.

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 150,000.00 €.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 10.000 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 150,000.00 €.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 10.05.2024

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti me një ose dy projekte në kuadër të kësaj thirrje. Periudha e zbatimit të projektit është 12 muaj duke filluar nga muaji shtator 2024. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku *një (1) vit* para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga fushat prioritare të thirrjes publike. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare* dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me udhëzimet për aplikuesit, janë në dispozicion në faqen e internetit të *MASHT*.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Rruga “Agim Ramadani”, nr. 10000, Prishtinë.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: Elhame.llapashtica@rks-gov.net